



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë më 14.11.2019

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

(shqyrtimi në parim)

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 14.11.2019 bëri prezantimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”, të paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

Në mbledhjen e komisionit morën pjesë Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj.Anila Denaj, Drejtoresha e Përgjithshme e Buxhetit znj.Mimoza Dhëmbi, si dhe përfaqësues të kësaj ministrie, të cilët bënë paraqitjen e projektbuxhetit për vitin 2020 para anëtarëve të Komisionit dhe iu përgjigjën pyetjeve në parim.

I. Baza kushtetuese e projektligjit, vlerësimi kushtetues dhe procedural

Propozimi i këtij projektligji vjen nga ana e Këshillit të Ministrave, në bazë të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës.

Projektligji është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës .

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

II. Objektivat e Buxhetit 2020

Projektbuxheti 2020 mbështet konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritit në Bashkimin Europian.

Projektbuxheti 2020 dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist.

Politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal për të vijuar trajektoren rënëse të raportit të borxhit publik ndaj PBB. Projektbuxheti 2020, planifikon më shumë burime si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi.

Rritja ekonomike parashikohet të jetë mbi nivelin prej 4% përgjatë viteve 2020-2022. Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.1% në vitin 2020 ndërkohë që norma mesatare e papunësisë parashikohet të bjerë në 10.6% në 2020.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2020-2022 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë.

Rijetëzimi rural do të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për zhvillimin rajonal. Rijetëzimi rural do të vazhdojë të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për këtë mandat, ku programi *100 Fshatrat* do të ketë rolin kryesor.

III. Realizimi i reformave

Sipas relacionit shoqërues, **projektbuxheti 2020** garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë. Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore, së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre.

➤ *Reforma e Drejtësisë*

Reforma në Drejtësi ka synim të përgjithshëm krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit dhe të mundësojë integritimin e tij në familjen evropiane. Reforma në drejtësi është një ndër prioritetet kyçe të Qeverisë Shqiptare dhe një ndër

çështjet më të përshtatshme që duhen trajtuar në kudër të pesë përparësive kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE-në.

Objektivat e Reformës në Drejtësi ne periudhën afatgjatë janë:

Synimet e Reformës në Drejtësi në periudhën afatgjatë janë:

- Të forcoje llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe të luftojë korrupsionin brenda sistemit të drejtësisë;
- Të demonstrojë progres të mëtejshëm me synim krijimin e precedentëve solidë të hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet;
- Të përmirësojë mekanizmat institucionale për të nxitur përpjekjet për ta sjellë legjislacionin ekzistues për drejtësinë për të mitur në përputhje me standarde ndërkombëtare;

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë përmban *tetë objektiva strategjike të nivelit të lartë*, të cilat janë:

- Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
- Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave.
- Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane.
- Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorrupsion përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.
- Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
- Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.
- Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.

➤ **Reforma të tjera në fushën e drejtësisë**

Projekt-buxheti 2020 mbështet gjithashtu edhe reforma të tjera në fushën e drejtësisë si:

- Forcimin e Luftës kundër Korrupsionit në Administratë;
- Rregullimin e çështjes së pronave në zbatim të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe akteve nënligjore.

Shpenzimet për *Fondin e Kompensimit në vlerë të Pronarëve*, parashikohen në total në masën **4.5 miliardë lekë** ose 0.3% e PBB.

- Garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri;
- Rritjen e performancës së Shërbimit të Provës në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve më të larta në fushën e masave alternative për realizimin e programeve sa më efikase në realizimin e rehabilitimit të të dënuarve me masa alternative.

Projektbuxheti 2020 parashikon për herë të parë si zë më vete mbështetjen buxhetore për veprimtarinë e strukturës së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe për veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

Në këtë projektbuxhet është parashikuar akomodimi i kërkesave buxhetore të institucioneve të krijuara rishtazi të reformës në drejtësi si Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Projekt-buxheti 2020 siguron gjithashtu vijimin e mbështetjes për tre organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke garantuar burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të përmbushur qëllimit të ushtrimit të funksioneve në mënyrë të plotë e të pavarur.

Njëkohësisht në këtë projekt-buxhet është parashikuar edhe shuma 300 milionë lekë si fond kontigjence për mbështetjen e nevojshme të reformës në drejtësi.

IV. Buxheti Vendor

Thellimi i decentralizimit fiskal, rritja e autonomisë financiare dhe konsolidimi i financave vendore janë ndër objektivat kryesore të qeverisë në drejtim të përdorimit me efektivitet të fondeve publike në nivel vendor dhe përmirësimit të standardeve të shërbimeve që i ofrohen komunitetit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Viti 2020, do të jetë viti i zbatimit të plotë të të gjithë instrumenteve të reja financiare të parashikuara në ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore (nr.68/2017), me synimin e konsolidimit të burimeve të financimit, për të garantuar një menaxhim më cilësor të shpenzimeve vendore.

Buxheti i pushtetit vendor për vitin 2020, do të jetë rreth 11.2 për qind më i lartë se ai i 2019-ës ose 5.7 miliardë lekë më shumë fonde për shërbime dhe investime publike.

Në buxhetin e vitit 2020, shuma e transfertës së pakushtëzuar e shpërndarë me anë të formulës rritet në 18 miliardë lekë, nga 17.6 miliardë lekë që ishte në buxhetin e vitit 2019, pra rreth 400 milionë lekë më shumë (ose rreth 3 % më e lartë) se në vitin 2019. Transferata e pakushtëzuar për vitin 2020, krahasuar me vitin 2015, është 5.7 miliardë lekë më shumë ose rreth 46.3 përqind më e lartë (sic paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm). Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar, tregon rëndësinë që ky buxhet i kushton procesit të decentralizimit dhe efikasitetit

të qeverisjes vendore. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2020, bazohet në një formulë të thjeshtë për t'u kuptuar dhe zbatuar, të bazuar në kritere që garantojnë funksionimin normal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Transferta e pakushtëzuar do t'u sigurojë njësive të vetëqeverisjes vendore mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur. Për vitin 2020, transferata e pakushtëzuar përbëhet nga dy pjesë: a) pjesa e përgjithshme dhe b) pjesa sektoriale. Formula e shpërndarjes së transfertës garanton një sistem më të drejtë ekualizimi fiskal duke ndihmuar bashkitë me kapacitet më të ulët fiskal. Mekanizmi i shpërndarjes së transfertës është i përshtatur në funksion të reformës administrativo-territoriale.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore në vitin 2020 do të jenë 26.9 miliardë lekë ose 18.2 për qind më të larta se në vitin 2019. Buxheti për vitin 2020 do të jetë rreth 3.2 për qind e PBB-së, dhe krahasuar me vitin 2015 rezulton me një rritje të ndjeshme me rreth 62 për qind.

Rritja e burimeve të buxhetit vendor në vitin 2020, krijon më shumë hapësira për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetaret (për funksionet ekzistuese dhe ato të reja të tranferuara me reformën administrativo territoriale) dhe njëkohësisht për uljen e stokut të detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga ndarja e vjetër administrativo territoriale dhe decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Objektivat kryesore për buxhetin vendor të vitit 2020, do të jenë në drejtim të:

1. Rritjes së burimeve të financimit të qeverisjes vendore me rreth 5.7 miliardë lekë ose 11.2% më shumë se në vitin 2019, rritje e cila sigurohet nga transferata e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore. Kjo rritje krijon hapësirat e nevojshme për përmirësimin e shërbimeve publike dhe fokusim më të madh në investime kapitale;
2. Ngritjes së kadastrës fiskale dhe implementimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore me qëllim taksimin sa më të drejtë, me objektiv rritjen e të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
3. Harmonizimit dhe unifikimit të procedurave mbi hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, konform standardeve ndërkombëtare;
4. Konsolidimit të procedurave dhe i sistemit të menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij;
5. Menaxhimit më të mirë të shpenzimeve administrative me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike cilësore me një kosto sa më të ulët. Kjo, do të arrihet nëpërmjet rritjes së peshës së shpenzimeve për investime dhe uljes së peshës që zënë shpenzimet administrative;
6. Rritjes së efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike në nivel vendor, duke identifikuar tregues të performancës së shërbimit të ofruar;
7. Përmirësimit të cilësisë së raporteve të monitorimit të buxhetit vendor dhe krijimi i një sistemi të monitorimit mbi bazën e treguesve të performancës.

8. Sigurimit të menaxhimit financiar transparent dhe efektiv për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
9. Rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin, në drejtim të monitorimit të publikimit të dokumenteve buxhetore dhe zhvillimin të seancave të vazhdueshme të konsultimit me qytetarët.
10. Implementimit të një metodologjie të mirëstrukturuar në lidhje me evidentimin e rasteve të vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Fokusi kryesor në buxhetin vendor të vitit 2020, do të jetë konsolidimi i procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhdimit të zbatimit të reformës administrative territoriale dhe decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet:

- Forcimit të disiplinës financiare në nivel vendor, nëpërmjet vendosjes së parimeve, rregullave, proceseve dhe procedurave për hartimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, duke synuar parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura (të papaguara).
- Planifikim dhe buxhetim eficient dhe i mirë-integruar i shpenzimeve publike në nivel vendor me synim rritjen e efektivitetit dhe përdorimit me ekonomi të fondeve publike.
- Përmirësimi i metodologjisë për analizën, ndjekjen dhe monitorimin e performancës buxhetore të njësive të vetëqeverisjes vendore. Nëpërmjet kësaj metodologjie do të synohet që përmes treguesve të performancës të matet efektiviteti i përdorimit të fondeve publike në nivel vendor.
- Forcimi i planifikimit strategjik dhe procesit të menaxhimit të buxhetit vendor.
- Menaxhimit efektiv të të ardhurave vendore si një mënyrë e rëndësishme për të rritur investimet dhe rialokimin e fondeve në interesin publik;
- Përcaktimit të rregullave për menaxhimin e situatave të vështirësive financiare si një formë e rëndësishme e vlerësimit të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- Rritja e parashikueshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së transfertave ndërqeveritare si një formë e rëndësishme e konsolidimit fiskal.

V. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA LIDHUR ME PROJEKTBUXHETIN NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE

Gjatë prezantimit të projektbuxhetit në Komision, Ministrja e Financave dhe Ekonomisë znj. Denaj informoi deputetët se projektbuxheti 2020 financon reforma të rëndësishme, siç është edhe reforma në drejtësi.

Ministrja theksoi se disa prej objektivave të projektbuxhetit të vitit të ardhshëm janë: sigurimi i rritjes ekonomike mbi nivelin e 4%; ulja e papunësisë në nivelin 10.6 %; mbajtja e deficitit

buxhetor në nivelin e 1.6 % të Produktit të Brendshëm Bruto; ulja e nivelit të borxhit publik në 62.2% të PBB-së në fund të vitit të ardhshëm.

Shpenzimet buxhetore të programuara për vitin 2020 janë rreth 532 miliardë lekë ose rreth 29.7% e Produktit të Brendshëm Bruto, me një rritje rreth 5.1% krahasuar me të pritshmin e vitit 2019. Projektbuxheti i vitit 2020 siguron një nivel të lartë të investimeve publike prej mbi 4.5% e Produktit të Brendshëm Bruto, në mbështetje të rritjes ekonomike dhe punësimit.

Gjithashtu, synohet ruajtja e Balancës Primare Pozitive, e cila do të jetë pozitive për të pestin vit radhazi në nivelin 0.7%, duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse.

Për sa i përket reformës në drejtësi, ministrja informoi se në këtë projektbuxhet në krahasim me buxhetin e vitit 2019, është parashikuar një shtesë prej 1.1 miliardë lekësh për institucionet e drejtësisë.

Ndërsa deputeti Bashkim Fino, relator i projektligjit për buxhetin, vlerësoi mbështetjen buxhetore për reformën në drejtësi dhe arsim, të cilat do kenë një impakt të ndjeshëm te qytetarët gjatë vitit të ardhshëm. Për shkak të rëndësisë që ka për funksionimin e institucioneve të drejtësisë, relatori e konsideroi këtë buxhet si buxheti i zbatimit të reformës në drejtësi.

Në vazhdim të diskutimit në Komision, ministrja Denaj iu përgjigj pyetjeve të deputetëve lidhur me parashikimet e buxhetit për sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, strategjinë e edukimit ligjor të publik, sistemin e ri të drejtësisë penale për të miturit, minoritetet, strehimin social, dhe reformimin e sistemit penitenciar.

Një vëmendje e veçantë gjatë diskutimit në Komision iu kushtua edhe parashikimit në projektbuxhet të fondeve për mbulimin e funksioneve të reja të njësive të vetëqeverisjes vendore, në fushat e diasporës, mbrojtjes civile, rinisë, dhe mekanizmit të mbrojtjes ndaj dhunës në familje.

Nga relatori u tërhoq vëmendja se pas ndryshimeve të ardhura me reformën administrative-territoriale është e nevojshme që të bëhet një rikategorizim i niveleve të pagave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe të merren masa për të verifikuar situatën financiare të këtyre njësive.

Pas përfundimit të diskutimeve të zhvilluara nga anëtarët e Komisionit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, duke konstatuar se:

- Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me nenet 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Komisioni i Ligjeve, në përputhje me afatet e përcaktuara Kalendarin e Kuvendit sipas nenit 79 të Rregullores për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të Shtetit të Vitit 2020, dhe bazuar në nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, ia paraqet këtë raport Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORI

Bashkim FINO

KRYETARI

Ulsi MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar
Tiranë më 21.11.2019

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”
(shqyrtimi nen për nen)

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjet e datave 18, 19, 20 dhe 21 nëntor 2019, bëri prezantimin nen për nen të projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2020” si dhe zhvilloi seanca dëgjimore me institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e pavarura të krijuara me ligj, sipas fushës së veprimtarisë, që mbulohen nga ky Komision, konkretisht me:

1. *Prokurorinë e Përgjithshme;*
2. *Gjykatën Kushtetuese;*
3. *Shkollën e Magjistraturës;*
4. *Këshillin e Lartë Gjyqësor;*
5. *Këshillin e Lartë të Prokurorisë;*
6. *Kolegjin e Posaçëm të Apelimit;*
7. *Komisionin e Pavarur të Kualifikimit;*
8. *Institucionin e Komisionerëve Publikë;*
9. *Institucionin e Presidentit;*
10. *Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;*
11. *Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;*
12. *Avokatin e Popullit;*
13. *Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;*
14. *Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;*
15. *Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;*
16. *Autoritetin Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit;*
17. *Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit;*
18. *Ministrinë e Drejtësisë;*
19. *Ministrinë e Brendshme (Gjendja Civile, Çështjet Vendore dhe Prefekturat);*

20. Shoqatat përfaqësuese të njëjësive të vetqeverisjes vendore¹;

Pas prezantimeve që bënë titullarët dhe përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të pavarura të krijuara me ligj, Komisioni konstatoi se:

▪ **Për projektbuxhetin e Prokurorisë së Përgjithshme**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dëgjoi kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme për buxhetin e vitit 2020.

Nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme u paraqit kërkesë për shtesë në investime, kryesisht për decentralizimin e sistemit të përgjimit, nga 130 milion lekë që është parashikuar në projektbuxhetin 2020, në 650 milion lekë.

Gjithashtu, u kërkua nga ky institucion të rishikohej mundësia për të mbajtur të njëjtin numër punonjësish, pasi në projektbuxhet parashikohen 60 punonjës më pak se viti 2019.

Lidhur me kërkesat e Prokurorisë së Përgjithshme për projektbuxhetin e vitit 2020, Komisioni vlerëson se fondet e parashikuara për këtë institucion në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020” janë të mjaftueshme për të garantuar funksionimin normal të institucionit.

Gjithashtu, gjatë diskutimit në Komision, u sqarua se ulja prej 60 punonjësish në numrin total të punonjësve të Prokurorisë së Përgjithshme, vjen si rezultat i ngritjes së SPAK.

▪ **Për projektbuxhetin e Gjykatës Kushtetuese**

Në mbledhjen e Komisionit mori pjesë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, i cili për projektbuxhetin e vitit 2020 për këtë institucion kërkoi që të merret parasysh kërkesa për shtesë në zërin investime për rikonstruksionin e godinës.

Në përfundim, për këtë institucion, Komisioni vlerësoi se fondet e parashikuara për këtë institucion në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020” janë të mjaftueshëm për të garantuar funksionimin normal të këtij institucioni, kjo referuar realizimit që ky institucion ka patur në veçanti për sa i takon zërit të investimeve në buxhetin e vitit 2019.

▪ **Për projektbuxhetin e Shkollës së Magjistraturës**

Në mbledhjen e Komisionit morën pjesë përfaqësues nga Shkolla e Magjistraturës të cilët u shprehën se projektbuxheti për vitin 2020 plotëson pritshmëritë e këtij institucioni, dhe nuk paraqitën kërkesa për fonde shtesë.

¹ Në seancën dëgjimore të organizuar nga Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut u ftuan edhe Shoqata e Automisë Vendore dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë. Në mbledhjen e komisionit mori pjesë vetëm Shoqata e Autonomisë Vendore, ndërkohë që Shoqata e Bashkive të Shqipërisë shprehu pamundësinë për të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore dhe paraqiti sugjerimet e saj për projektbuxhetin 2020 në rrugë elektronike

▪ **Për projektbuxhetin e Këshillit të Lartë Gjyqësor**

Prezantimi i projektbuxhetit për Këshillin e Lartë Gjyqësor u bë nga Kryetarja e këtij institucioni, znj. Naureda Llagami, z. Maksim Çoku, zv. Kryetar dhe znj. Luljeta Laze, Drejtoreshë e Buxhetit.

Buxheti i propozuar për vitin 2020 për Këshillin e Lartë Gjyqësor, është **afërsisht 3,48 miliardë lekë**.

Përfaqësuesit e KLGJ-së gjatë prezantimit të projektbuxhetit të vitit 2020 si organ qeverisës i sistemit gjyqësor, kërkuan që Komisioni të marrë parasysh kërkesat e mëposhtme për buxhetin e KLGJ-së:

- shtesë në zërin investime për të krijuar infrastrukturën e nevojshme për teknologjinë e informacionit në godinën e re;
- fond për mirëmbajtjen e programit elektronik ekzistues të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS i cili ka kaluar në administrim të KLGJ;

Për buxhetin e sistemit gjyqësor u paraqitën kërkesat e mëposhtme:

- shtesë për shpenzime operative të kërkuara nga gjykatat (Programi i Buxhetit Gjyqësor) për mirëfunkcionimin e aktivitetit të gjykatave në të tre nivelet në shumën 60 milion lekë;
- shtesën në investime për fillimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore në shumën 100 milion lekë;
- shtesën në Programin e Buxhetit Gjyqësor si nevojë buxhetore për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi;

Në përfundim, Komisioni vendosi t'i propozojë komisionit përgjegjës për ekonominë dhe financat të miratojë kalimin e fondit për sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS në masën 25 milion lekë nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë në buxhetin e KLGJ.

Ndërsa për nevojat buxhetore të KED për vitin 2020, Komisioni vlerëson se ato do të përballohen nga fondi i kontigjencës prej 300 milionë lekë për mbështetjen e nevojshme të reformës në drejtësi i parashikuar në projektbuxhetin 2020.

▪ **Për projektbuxhetin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë**

Prezantimi i projektbuxhetit për Këshillin e Lartë të Prokurorisë u bë nga Kryetari i këtij institucioni, z. Gent Ibrahimimi dhe znj. Ilirjana Nano, Sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Nga Kryetari e KLP-së u kërkuar:

- shtesë punonjësish në strukturën e KLP për:
 - 4 sekretarë pranë secilit komision dhe pranë Këshilltarit të Etikës;
 - shoferë për secilin nga anëtarët e KLP të cilët kanë statusin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë;
 - 1 specialist të teknologjisë së informacionit;
 - 3 punonjës pastrimi.
- shtesë në fondin e shpenzime operative në zërat: shpenzime qiramarrje automjetesh, dieta, shpenzime pritje-përcjellje, shpenzime të ruajtjes dhe sigurisë së institucionit, shpenzime transporti;
- shtesë në fondin e investimeve për blerjen e dy automjeteve, për mobilimin e godinës si dhe sigurimin e pajisjeve të regjistrimit të mbledhjeve të KPL-së pas transferimit në godinën e re;

Lidhur me kërkesat e paraqitura Komisioni vlerësoi se fondet e parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2020 garantojnë funksionimin normal të institucionit, në përmbushje të kompetencave të tij ligjore.

▪ **Për projektbuxhetin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

Prezantimi i projektbuxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit u bë nga Kryetarja e këtij institucioni, znj. Natasha Mulaj dhe përfaqësue të këtij institucioni.

Përfaqësuesit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjatë seancës dëgjimore në komision paraqitën kërkesat për:

- rishikim të fondit të pagave duke përllogaritur edhe efektin financiar të shtesën për vështirësi dhe shtesës për vjetërsi për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor.
- shtesë për natyrë veçantë pune për personelin administrativ.
- rishikim të shtesës për vështirësi për gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
- shtesë në numrin e punonjësve të KPA me 2 punonjës shtesë dhe riklasifikim të pagave për disa kategori të punonjësve të personelit administrativ.
- shtesë në zërin investime në shumën 12.7 milion lekë për blerje skaner për kontroll dhe dedektor.

Komisioni duke marrë në konsideratë problematikën e shfaqur nga ky organ gjatë vitit 2019 por edhe kuadrin ligjor, vlerësoi të nevojshme që Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masat e nevojshme për të propozuar në Këshillin e Ministrave, aktet nënligjore që do të rregullojnë:

a. metodologjinë e përllogaritjes së vjetërsisë në punë për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor;

b. përcaktimin e shtesës për vështirësi për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor për tre institucionet e rivlerësimit kalimtar, në zbatim të kërkesave të nenit 29 pika 5 të ligjit nr.84/2016.

Këto akte nënligjore duhet të propozohen dhe të miratohen përpara shqyrtimit nën për nën dhe në tërësi të projektbuxhetit nga Komisioni përgjegjës për ekonominë dhe financat me qëllim përlllogaritjen dhe parashikimin e efektit financiar në projektbuxhetin e vitit 2020 për këtë institucion.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

Prezantimi i projektbuxhetit për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, u bë nga Kryetarja e këtij institucioni, znj.Genta Bungo dhe përfaqësues të këtij institucioni. Përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë seancës dëgjimore në komision parashtruan kërkesën për:

Rishikim të fondit të pagave duke përlllogaritur edhe efektin financiar të shtesën për vështirësi dhe shtesës për vjetërsi për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor.

Komisioni duke marrë në konsideratë problematikën e shfaqur nga ky organ gjatë vitit 2019 por edhe kuadrin ligjor, vlerësoj të nevojshme që Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masat e nevojshme për të propozuar në Këshillin e Ministrave, aktet nënligjore që do të rregullojnë:

a. metodologjinë e përlllogaritjes së vjetërsisë në punë për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor;

b. përcaktimin e shtesës për vështirësi për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor për tre institucionet e rivlerësimit kalimtar, në zbatim të kërkesave të nenit 29 pika 5 të ligjit nr.84/2016.

Këto akte nënligjore duhet të propozohen dhe të miratohen përpara shqyrtimit nën për nën dhe në tërësi të projektbuxhetit nga Komisioni përgjegjës për ekonominë dhe financat me qëllim përlllogaritjen dhe parashikimin e efektit financiar në projektbuxhetin e vitit 2020 për këtë institucion.

▪ **Për projektbuxhetin e Institucionit të Komisionerëve Publikë**

Prezantimi i projektbuxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë u bë nga dy Komisionerët Publikë, z. Darjel Sina dhe z. Florjan Ballhysa. Komisionerët Publikë, gjatë seancës dëgjimore në komision u shprehën se:

Fondet e akorduara në zërin paga dhe sig shoqërore për vitin 2020 nuk reflektojnë shtesën në strukturën e miratuar për IKP me vendimin e Kuvendit nr. 102/2018 prej 4 punonjësish.

Njëkohësisht ata kërkuan rishikim të fondit të pagave duke përlllogaritur edhe efektin financiar të shtesën për vështirësi dhe shtesës për vjetërsi për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor.

Komisioni duke marrë në konsideratë problematikën e shfaqur nga ky organ gjatë vitit 2019 por edhe kuadrin ligjor, vlerësoj të nevojshme që Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masat e nevojshme për të propozuar në Këshillin e Ministrave, aktet nënligjore që do të rregullojnë:

- a. metodologjinë e përlogaritjes së vjetërsisë në punë për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor;
- b. përcaktimin e shtesës për vështirësi për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor për tre institucionet e rivlerësimit kalimtar, në zbatim të kërkesave të nenit 29 pika 5 të ligjit nr.84/2016.

Këto akte nënligjore duhet të propozohen dhe të miratohen përpara shqyrtimit nën për nen dhe në tërësi të projektbuxhetit nga Komisioni përgjegjës për ekonominë dhe financat me qëllim përlogaritjen dhe parashikimin e efektit financiar në projektbuxhetin e vitit 2020 për këtë institucion.

Lidhur me fondin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore, Komisioni rekomandon që të bëhen rakordimet përkatëse me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe të pasqyrohet në zërat e pagave dhe sigurimeve shoqërore fondi i nevojshëm për të përballuar efektet financiare për punonjësit e miratuar sipas vendimit të Kuvendit.

- **Për projektbuxhetin e Institucionit të Presidencës**

Sipas projektbuxhetit për vitin 2020, për këtë institucion është parashikuar në total buxheti prej 252.3 milion lekësh, me një rritje 1.7% krahasuar me buxhetin e vitit 2019.

Në seancën e zhvilluar në Komision, nga përfaqësuesit e Institucionit të Presidencës u paraqiti kërkesa për shtesë në zërin investime, në masën 36 milion lekë, për projektin e menaxhimit dixhital.

Lidhur me kërkesat e këtij institucioni për buxhetin e vitit 2020, Komisioni vendosi t'i rekomandojë Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat të vlerësoi mundësinë që shtesa prej 36 milion lekësh të akordohet e ndarë në dy vite, duke filluar me buxhetin e vitit 2020, ku në fondin e investimeve të shtohen 18 milionë lekë për këtë institucion.

- **Për projektbuxhetin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive**

Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në Komisionin për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, përfaqësuesit e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit nuk paraqitën kërkesa për fonde shtesë.

- **Për projektbuxhetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Në mbledhjen e Komisionit përfaqësuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve paraqitën kërkesat për këtë institucion, si më poshtë:

Në zërin investime kërkohet shtesë fondi për:

1. për shtesë kati në godinën ekzistuese në masën 14.069 milion lekë;
2. Blerje të dy automjete të reja, në vlerën 6.175 milion lekë.

Komisioni vlerëson se fondet e akorduara për këtë institucion në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020” akomodojnë nevojat për garantimin e funksionimit normal të këtij institucioni.

▪ **Për projektbuxhetin e Avokatit të Popullit:**

Në mbledhjen e Komisionit përfaqësuesit e Avokatit të Popullit paraqitën kërkesat e mëposhtme:

- shtesë 2 milionë lekë në zërin investime;
- rishikim të fondit të pagave për AP dhe komisionerëve;
- shtesë në zërin e shpenzimeve operative për mbulimin e aktiviteteve promovuese të institucionit dhe të aktiviteteve me rastin e 20 vjetorit të institucionit.

Komisioni miratoi kërkesat e këtij institucioni sa më poshtë:

- **2 milionë lekë shtesë në zërin investime;**
- **zëri mallra dhe shërbime të shtohet dhe të bëhet 16.5 milion lekë, siç ka qenë parashikuar dhe për vitin 2019.**

Gjithashtu, në vijim të rekomandimeve për fondin e pagave të institucioneve të rivlerësimit kalimtar, Komisioni rekomandon që në aktin nënligjor që do të rregullojë metodologjinë e përlogaritjes së vjetërsisë në punë të adresohet edhe çështja e llogaritjes së vjetërsisë në punë për komisionerët e AP.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

Komisioni u njoh me prezantimin e projektbuxhetit nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi z. Robert Gajda, i cili paraqiti kërkesën për:

- fonde shtesë në zërin investime për përfundimin e realizimit të përshtatjes së ndërtesës me elementet e PAK, procedurë e filluar me fondet e akorduara në vitin 2019.
- rritje të fondit të shpenzimeve operative me qëllim plotësimin e nevojave të institucionit.
- akomodim i fondeve për pagat dhe sigurimet shoqërore në përputhje me numrin e punonjësve të përcaktuar në vendimin përkatës së Kuvendit.

Komisioni miratoi kërkesën për rritjen e zërit të shpenzimeve operative duke parashikuar që ky fond të jetë në masën 12 milion lekë nga 11.1 milion të parashikuara në projektligjin për buxhetin e vitit 2020.

Për sa i takon shtesës për investime, i rekomandohet komisionit përgjegjës, që nëse procedura e prokurimit për realizimin e këtij investimi, tashmë të filluar, nuk arrihet të përmbyllet brenda këtij viti, të parashikohet akordimi i fondit të nevojshëm prej 3 milion lekë shtesë në projektbuxhetin e vitit 2020 në zërin investime.

Lidhur me fondin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore, të bëhen rakordimet përkatëse me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe të pasqyrohet në zërat e pagave dhe sigurimeve shoqërore fondi i nevojshëm për të përballuar efektet financiare për punonjësit e miratuar sipas vendimit të Kuvendit.

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Komisioni u njoh me kërkesën e paraqitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale z. Besnik Dervishi, i cili paraqiti kërkesë për:

Shtesë strukture për 10 punonjës me qëllim përbushjen e funksioneve të këtij institucioni në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”, monitorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave personale nga organet ligjzbatuese.

Komisioni miratoi kërkesën për shtimin e strukturës dhe organikës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me 3 punonjës shtesë (duke e çuar në 40 numrin e punonjësve) me qëllim përbushjen e funksioneve të parashikuara nga legjislacioni për të drejtën e informimit dhe legjislacioni i Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale (pasi 2 punonjës janë shtuar në vitin 2018).

▪ **Për projektbuxhetin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**

Në mbledhjen e Komisionit mori pjesë Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Pranvera Strakosha, e cila u shpreh se projektbuxheti i vitit 2020 plotëson kërkesat e këtij institucioni, **dhe nuk paraqiti kërkesa për fonde shtesë.**

▪ **Për projektbuxhetin e Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit**

Kryetarja e Autoritetit gjatë seancës dëgjimore në Komision paraqiti kërkesat si vijon:

- Kërkesë për rakordimin e fondit të pagave për shtesën e punonjësve të parashikuar në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”.
- shtesë në zërin e shpenzimeve operative.
- shtesë në zërin investime:

- Për ngjitjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve.
- Përshtatje të zyrave të administratës dhe blerje të pajisje kompjuterike dhe mobiljeve;

Komisionit miratoi kërkesën për:

- pasqyrimin në zërin paga dhe sigurime shoqërore të fondit të nevojshëm për të përballuar efektet financiare që rrjedhin nga shtesa prej 10 punonjësish e parashikuar në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”.
- shtesë fondi për investime në vlerën 35 milion lekë për përshtatje të ambienteve të zyrave.

▪ **Për projektbuxhetin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit**

Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në Komisionin për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit **nuk paraqiti kërkesa për fonde shtesë.**

▪ **Për projektbuxhetin e Ministrisë së Drejtësisë**

Prezantimi i projektbuxhetit për ministrinë e Drejtësisë u bë nga Ministria e Drejtësisë znj. Etilda Gjonaj.

Ministria e Drejtësisë për periudhën 2020-2022 do të prioritetizojë:

- Jetësimin e Reformës në Drejtësi;
- Jetësimin e reformës në Drejtësinë Penale për të miturit;
- Forcimi i Luftës kundër Korrupsionit në Administratë;
- Rregullimin e çështjes së pronave në zbatim të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe akteve nënligjore;
- Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe siguron ri-integrimin e tyre në shoqëri;
- Rritja e performancës së Shërbimit të Provës në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve më të larta në fushën e masave alternative për realizimin e programeve sa më efikase në realizimin e rehabilitimit të të dënuarve me masa alternative.
- Ndarjen e fondit të vënë në dispozicion kundrejt subjekteve që kanë përfituar të drejtën e kompensimit duke bërë që të rritet numri subjekteve të kompensuara nga viti në vit.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2020 Ministria e Drejtësisë ka në përbërje të saj nëntë programe buxhetore, të cilat janë ndarë në: planifikim– menaxhim – administrim; ndihma juridike; Publikimet Zyrtare, Mjekësia Ligjore, Sistemi i Burgjeve, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, Shërbimi për Çështjet e Birësimeve, Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Shërbimi i Provës. Buxheti total i planifikuar për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2020 **është 11.037 miliard lekë.**

Gjatë diskutimit në Komision, Ministria e Drejtësisë nuk paraqiti kërkesa për fonde shtesë për buxhetin e këtij institucioni për vitin 2020.

- **Për projektbuxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për pjesën e gjendjes civile, çështjet vendore dhe prefekturat.**

Në mbledhjen e Komisionit, për të paraqitur projektbuxhetin e viti 2020, mori pjesë Ministri i Brendshëm, z.Sandër Lleshaj si dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

Në projektligjin e buxhetit të vitit 2020 Ministria e Brendshme ka në përbërje të saj pesë programe buxhetore, të cilat janë ndarë në: planifikim – menaxhim – administrim, Policia e Shtetit, Garda e Republikës, prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor si dhe Gjendja Civile. Ministri i Brendshëm, z.Lleshaj theksoi se buxheti i vitit 2020 për këtë ministri do të jetë në funksion të rritjes së luftës kundër krimit të organizuar.

Projektbuxheti për vitin 2020 për Ministrinë e Brendshme ka një rritje 1.4% në krahasim me buxhetin e vitit 2019. Rritja e parashikuar për buxhetin e gjendjes civile është parashikuar të jetë 1%, ndërsa për prefekturat 1.3% në krahasim me vitin 2019.

Buxheti për prefekturat, sqaroi z.Lleshaj, do të jetë në funksion të rritjes së rolit të përfaqësuesve të pushtetit qendror në nivel vendor.

Për gjendjen civile do të ketë rritje të investimeve me pajisje elektronike për funksionimin online të shërbimit të gjendjes civile.

Gjatë diskutimit në Komision, Ministria e Brendshme nuk paraqiti kërkesa për fonde shtesë për buxhetin e këtij institucioni për vitin 2020.

Të gjitha ndryshimet e miratuara më sipër nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të reflektohen në tabelën 1 të projektligjit “Buxheti 2020 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve të buxhetore”, si dhe në tabelën 2 që parashikon numrin e punonjësve për vitin 2020.

➤ **Buxheti Vendor**

Për sa i takon buxhetit të njërive të vetqeverisjes vendore, pas shqyrtimit të rekomandimeve dhe sugjerimeve të paraqitura nga shoqatat përfaqësuese të njërive të vetqeverisjes vendore, dhe bazuar në parashikimet e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” në Komisioni vendosi t'i adresojë komisionit përgjegjës për ekonominë dhe financat rekomandimet e mëposhtme:

1. Shuma totale vjetore e fondeve për t'u ndarë ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, gjatë vitit 2020 të jetë në përputhje me

parashikimet e vendosura nga neni 23 i ligjit 68/2017 **duke u përlogaritur jo më pak se 1 për qind e produktit të brendshëm bruto.**

2. Në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 25 i ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara prej:
 - a. 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale; dhe
 - b. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;të parashikohen për tu transferuar te njësitë e vetëqeverisjes vendore.
3. Të vlerësohet mundësia e fshirjes së borxheve të prapambetura për njësitë e vetqeverisjes vendore, sipas kuadrit ligjor.
4. Të rishikohet skema e kategorizimit të pagave në njësitë e vetqeverisjes vendore duke kaluar nga sistemi me 6 kategori në sistemin me 2 deri në 3 kategori.

Këto rekomandime të reflektohen edhe në dispozitat dhe tabelat përkatëse që parashikojnë transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga transferimi i taksave të ndara.

- PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke vlerësuar domosdoshmërinë për garantimin e mirëfunksionimit të organeve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, bazuar në nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, u shpreh dakord për miratimin e projektligjit “Për Buxhetin e Shtetit të Vitit 2020”, nen për nen, dhe në tërësi.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në përputhje me afatet e përcaktuara në kalendarin e Kuvendit sipas nenit 79 të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e projektbuxhetit të Shtetit të Vitit 2020, e paraqet këtë raport në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, si dhe në seancën plenare.

(Bashkëlidhur tabela përmbledhëse me kërkesat e miratuara nga Komisioni)

RELATOR

KRYETAR

Bashkim FINO

Ulsi MANJA